



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 107/13
Prishtinë, më 17.05.2013, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hykmete Bajrami, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi dhe Xhevdet Neziraj.

Munguan: Naser Osmani, Sevdije Lama dhe Duda Balje.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Sabrije Saliuki – Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Krenar Bujupi dhe Ejup Hasolli nga ZRRE, Hilmi Demolli dhe Adelina Sopi-KKTK, Naim Abazi, Miran Zeneli dhe Islam Cakaj nga KPMSHCK.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit dt. 08.05.2013;**
3. **Rishqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Zyrës Rregullative për Energji për vitin 2012;**
4. **Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2012;**
5. **Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor të Këshillit të Pavarur për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2012;**
6. **Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit Hetimor Parlamentar për lejimin e mjeteve buxhetore;**
7. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit dt. 08.05.2013

Kryetarja konstatoj se procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Rishqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Zyrës Rregullative për Energji për vitin 2012

Kryetarja sqaroi se kemi pas vërejtje për mënyrën e shpenzimit të mjeteve dhe rreth një vendimi të marrë për lirim nga pagesa e taksave për të licencuarit dhe si rezultat kemi kërkuar informata shtesë me shkrim për këto çështje.

Krenar Bujupi sqaroi se arsyeja e vendimit për lirim nga pagesa e taksës të licencuarve, është në pajtim me ligjin për rregullatorin e energjisë dhe qëllimi ka qenë të mos ngarkohen konsumatorët. Mendimi se ZRRE ka bërë ngritje të pagave për punëtorët e saj në vitin 2012, kjo është diskutuar edhe gjatë vitit të kaluar. Kemi pas një viti të ngarkuar, jemi pjesë e traktatit të Athinës, ku bëjnë pjesë në Komisione të ndryshme Evropiane për çështje të energjisë, kemi ndryshim të sektorit publik në sektor privat. Udhëtimet zyrtare jashtë vendit janë bërë duke kursyer paratë e buxhetit. Tejkalimi i buxhetit për shërbimet intelektuale dhe këshillëdhënëse- ku hyjnë përkthimet në dy gjuhë si dhe një numër të madhë të raporteve për çështje të cilat kanë ndodhur. Janë bërë shqyrtime publike të tarifave, transferime të licencave dhe kjo ka ndikuar në shpenzime më të mëdha.

Hykmete Bajrami më intereson të kuptoj më shumë lidhur me vendimin e ZRRE-së për detyrimin e KEK-ut për ti kthyer kompanisë Limak-Qalik 17.8 mil €, nuk është e qartë se çka po ndodh. Të gjitha informatat janë se ZRRE në bashkëpunim me KEK-un pajtohen për planin e të hyrave brenda vitit. Sipas informatave janë planifikuar 215 milion euro të hyra, pastaj është diferenca e importit për këtë 17.8 mil €. Pse këto të holla duhet ti transferohen kompanisë që e ka privatizuar ?

Krenar Bujupi sqaroi se 17.9 mil € është diskutuar shumë në media. Kjo ka të bëjë me operimin sa më të saktë të sistemit energjetik të Kosovës. Në vitin 2012 i kemi lejuar KEK-ut të hyra 215 mil € nga këto të hyrat që i kemi lejuar për import-eksport, për mbledhjen e tarifave ka rezultuar se KEK-u ka importuar më pak, ka eksportuar më shumë dhe ka ardhur deri tek 17.9 mil €. Kjo do të thotë se të hyrat që i kemi lejuar me disa figura të importit më të larta nga ato që kanë qenë të realizuara. Me figurat që nuk janë realizuar gjatë vitit është detyrim që ato të holla të kthehen tek konsumatorët e rregulluar sepse janë marrë gjatë vitit 2012 nga konsumatorët e rregulluar dhe duhet patjetër të kthehen. Për shkak të sistemit të energjisë dhe licencave që i kemi vetëm, furnizuesi publik ka qasje në konsumatorë dhe marrëdhënie financiare me konsumatorë, pra i mbledh të hollat nga konsumatorët dhe paguan sistemi. Sa i përket 17.9 mil duhet kuptuar se këto të holla janë të konsumatorit të rregulluar që janë marrë gjatë vitit 2012 dhe duhet të kthehen gjatë vitit 2013.

Hykmete Bajrami pyet se kush janë konsumatorë të rregulluar dhe si do të dijmë se do të na kthehen 17.9 milion euro ?

Krenar Bujupi thekson se të gjithë në Kosovë janë konsumatorë të rregulluar. Kostoja e sistemit është 242 milion euro e cila nevojitet për furnizim. Nuk e kemi lejuar furnizuesin për ta futur në faturë këtë 17.9 milion euro.

Sali Asllanaj konsideroj se interpretimi i tillë i raporteve- të ardhurat e dedikuara i japin të drejtë edhe ti lirojnë nga taksa furnizuesit, nuk është transformim adekuat. Nuk mund ta ketë rolin humanitar ZRRE-ja sepse duhet me ligj të jenë të rregulluara se në çfarë rasti të jenë të liruara kompanitë. Ajo që bie në sy është edhe kompensim shtesa sikur keni qenë shumë zemërgjerë. Ka shpenzime që nuk besoj se i ka ndonjë institucion tjetër.

Latif Gashi arsyetimin të cilin e keni bërë në lidhje me lirim nga të licencuarve janë të mjaftueshme. Por në asnjë mënyrë, në legjislacion nuk shkruan se ju mbledhni të hyra vetëm për institucionin tuaj. Pra

nuk ka bazë ligjore që të licencuarit janë liruar. Ndërsa sa i përket çështjes që e ngriti deputetja Hykmete , duhet që të informohet opinioni dhe qytetari i thjeshtë dhe mos të bëjmë paragjykime.

Xhevdet Neziraj planifikimet buxhetore që bëhen në fillim të vitit është mirë të realizohen, por tek ZRRE-ja gjithëmon po ndodhë që të ketë tejkalime të mëdha sidomos tek shërbimet intelektuale. Nëse do të angazhoni një përkthyes Shqip-Serbisht , do të zvogëloheshin ato shërbime intelektuale .Duhet të vetdijesohemi që atë që e planifikojmë të realizojmë dhe mos të kalohet , sepse në të vërtetë po ka shpenzime të panevojshme.

Kryetarja lirimi i të licencuarve me qëllim të harmonizimit të hyrave nuk ka bazë, sepse nëse ju nuk mund të realizoni të hyra çfarë doni të bëni, të lypni para nga qeveria. Ky vendim i pagave të cilin e ka marrë ZRRE-ja nuk është i miratuar prej askujt dhe ju keni përfituar në një mënyrë apo një tjetër ju kanë nda mjetet mirëpo ky vendim nuk është i aprovuar nga askush dhe në një farë mënyre është i pazbatueshëm. Është shqetësuese që nuk po gjendet mënyra me u hartuar ligji për pagat e funksionareve të lartë publik dhe për stafin e agjencioneve të pavarura. Në muajin dhjetor paga e kryesuesit të ZRRE-së 4156 euro , ka kompenzim 1781euro, qfarë është ky kompenzim për kryesuesin dhe për anëtarët e bordit?

Krenar Bujupi duhet të kuptohet që planifikimi nuk mund të bëhet 100% dhe nuk mund të quhet vjedhje e kategorive për të cilat kemi bërë planifikim. Nuk është bërë për shkak të mos seriozitetit apo mos qasje të planifikimit të duhur , mirëpo për shkak të natyrës së punës disa nga kategoritë është dasur të ndryshohet. Ndërsa sa i përket çështjes që e ngriti deputetja , është diskutuar dhe kemi lëshuar dokumentet tona në opinion dhe nëpër gazeta kemi lëshuar dokumente tona të ZRRE-së. Mirëpo nuk po kemi qfarë të bëjmë tjetër si ZRRE për qeshtjet politike , pra nuk mund të hymë në çështje politike kur ka konflikte mes dy e më shumë subjekteve politike.

Latif Gashi nuk kemi të bëjmë me qështje politike, por ju si institucion duhet saktësisht me organizua debat publik, me i thirr qytetarët që janë të interesuar. Pse nuk ka dalë çështja e milionave pa u shitur KEK-u, pasi u shit ajo pjesë e distribucionit dhe shkaktoni dilemë dhe huti edhe nëse nuk jeni diqka gabim krijon huti.Dhe sa i përket asaj se janë liruar tarifat e të licencuarve nuk kamë ndonjë përgjigjeje nga ju.

Krenar Bujupi vendimi për lirimin e të licencuarve është i drejtë dhe ka mbështetje ligjore. Shumica e buxhetit tonë merret nga KEK-u , ata janë të licencuarit që japin më së shumti para,të gjitha parat që KEK-u i jep për licenca për shpenzime të gjitha përfundojnë në tarifa. Buxheti i ZRRE-së ndikon në tarifën e konsumatorëve, sadopak por ndikon ,për atë është parimi që mos ti ngarkojmë konsumatorët më shumë se sa që kemi nevojë . Për sa i përket kompenzimi për pagat , në muajin dhjetor pas alokimit të buxhetit që e kemi pasur më të vogël , bordi i ZRRE-së ka marrë vendim me i zvogëlue të gjitha pagat për 15%, dhe nëse na mbesin të hyra për paga i kthejmë ato që na mbesin dhe prap janë kthyer 10%.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

1. Të mos miratohet Raporti vjetor financiar i Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2012.
2. Kuvendi në pajtim me nenin 3.7 të Ligjit nr. 03/L-075 për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës, të kërkojë nga Zyra e Auditorit të

Përgjithshëm, të kryej auditimin e performacës së Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2012 dhe raportin e auditimit t'ia dërgojë Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor për vitin 2012

Kryetarja thesroi se Këshilli në pajtim me ligjin ka dërguar raportin e punës dhe financiar në Kuvend, i cili është plotësuar sipas formularëve të dërguar nga komisioni

Latif Gashi kërkoj sqarime për kategorinë paga edhe meditje dhe ka të bëjë me shpenzimet pothuajse 100%, përkundër faktit që një pjesë e anëtarëve të Këshillit nuk kanë qenë aktiv gjithë vitin?

Adelina Sopi sqaroi se tre antarët të Këshillit janë paguar deri në korrik të viti të kaluar, kur edhe iu ka skaduar mandati ligjor, mirëpo katër anëtarët e tjere që nuk janë të përfshirë në listat e pagave, pasi që kanë pasur marrëdhënie tjera pune dhe sistemi në Kosovë nuk lejon pagesa tjera dhe ata janë tërhequr në mënyrë të heshtur. Stafi i Këshillit realizon një shtesë për punët jashtë orarit në pajtim me rregulloren e Qeverisë për kompensime dhe këtu qëndron arsyeja e nivelit të shpenzimit të buxhetit për paga dhe meditje. Në fund të vitit të kaluar një antar i bordit të komisionit, ka parashtruar kërkesë për pagesë të pagës, në fillim nuk i është paguar për arsye që ka qenë i rikrotuar dikun tjetër, në muajin tetor ka bërë kërkesë për një pagesë retroaktive, në Këshill kemi bërë kërkesë në MAP dhe një shumë e konsiderueshme e mjeteve na ka shkuar për konpenzime tija.

Latif Gashi për sa e kuptova unë mjetet që kanë qenë të dedikuara për pagat e anëtarëve të Këshillit që nuk janë ekzekutuar për shkak të skadimit të mandatit apo për pengesa ligjore, atë pjesë të buxhetit e keni shpërndarë tek punëtorët që i kanë krye disa funksione në emër të shtesave?

Adelina Demolli anëtarëve të bordit iu ka skaduar mandati në korrik por deri në shtator kanë gjeneruar të ardhura. Sa i përket kompensimit të stafit për punët jashtë orarit janë bërë në pajtim me rregulloren në fuqi.

Kryetarja sa i përket anëtarëve të Këshillit, pasi që iu ka skaduar mandati me 1 korrik dhe nuk ka pas logjik me u pague deri në shtator. Lidhur me qështjen e kompensimeve të stafit, është auditori që vlerëson ligjshmërinë e tyre. Nuk mundet që mjetet e planifikuar për anëtarët e bordit të shpërndahen për stafin, është dashur të mbesin në buxhet. A ka pasur planifikim të mjeteve për punë jashtë orarit për stafin.

Adelina Demolli keto mjete në fillim të viti i kemi dorëzuar në administratën publike dhe e kemi njoftu ministrin e financave me planifikimin vjetor për mjetet me list me specifikacion dhe me konpenzim.

Latif Gashi po të ishin 4 antarët e Këshillit aktiv apo po të zgjidheshin anëtarët e rinj nga Kuvendi, ku i kishit marr mjetet për pagat e tyre?

Adelina Demolli vazhdimisht edhe në vitin e kaluar kemi bërë kërkesa për rritjen e buxhetit, përfshirë edhe pagat dhe meditjet për anëtarët e Këshillit, por përgjigjen e kemi marrë le të emërohen anëtarët e pastaj e shofim.

Latif Gashi propozoj të Këshilli të sjell informatat shtesë për rrjedhën e pagave dhe meditjeve të punëtorëve të këtij institucioni dhe arsyeshmërinë për marrjen e kompensimeve dhe shtesave.

Sali Asllanaj po me duket se po flasim për gjëra të vogla, sepse buxheti është shumë i vogël, mendoj se është fakt që shtesa janë marrë për shkak të angazhimeve shtesës të stafit dhe të dhënat janë përfshirë në raport.

Kryetarja propozoj që të përkrahim raportim me kërkesën që ti dërgohen komisionit informatat shtesë të detalizuara për rrjedhen e shpenzimeve për paga dhe mëditje sipas kërkesës së deputetit Gashi.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

1. I rekomandohet Kuvendit miratimin e raportit financiar vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë për vitin 2012
2. Kërkohet që Këshillit, ti dërgojë komisionit informata shtesë që arsyetojnë rrjedhen e shpenzimeve në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje.

5. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor të Këshillit të Pavarur për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2012

Kryetarja e ky keshill i ka shpenzuar buxhetin prej 97%, edhe pse nuk i kan pranuar të gjithë punëtorët e miratuar me ligjin e buxhetit, nga 25 janë 23 të punësuar, vetëm 13 cent iu kanë tepruar për paga edhe mëditje. Një sqarim për shpenzimet për paga dhe mëditje.

Naim Abazi buxheti i Këshillit është 217 mi 872 euro, nuk ka pas rrishikim e as nuk ka pasur shtesa sa i perket planit të shpenzimeve. Vlen te theksohet se edhe raportet e auditori nuk paraqesin shqetsim për këtë institucion. Sa i perket vijes buxhetore për pagat edhe mëditje, është e vërtet se i kemi dy punëtor të parekrutuar, për shkak se kushte ne te cilat këshilli operon ka qenë e pa mundur me i marr edhe dy veta.

Sali Asllanaj objektivisht ajo që bie në sy është shpenzimi i buxhetit për paga që nuk korrespodon me numrin e punëtorëve, janë planifikuar dy punëtor dhe nuk i keni marrë, ku kanë mbet paret në emër të këtyre punëtorve, me që buxheti është shpenzuar 100%.

Miran Zeneli theksoi se kanë qenë pozita të lejuara nga Kuvendi, por jo të mbuluar me buxhet.

Kryetarja kjo qka po ngrit drejtori nuk ka logjik se te gjitha pozita janë miratu me buxhetin te cilin u aprovua dhe nuk besoj se kemi miratu pozita në menyrë të veqantë pa buxhet.

Islam Cakaj qe nga 2008 janë të aprovuar nga ana e Kuvendi 25 punëtor, tani kemi 23 punëtor, ndërkaq për dy punëtor nuk kemi patur mjete të lejuara. Ndërkaq këtë vit i kemi mjetet e lejuaraedhe për ata dy punëtor.

Latif Gashi ne momenti kur ju ka leju mundesia për punëtorët shtesë kjo do të përcillje edhe me lejimin e mjeteve buxhetore, qoftë në ministrinë e financave apo në Kuvend. Menodjë që është e nevojshme të dërgoni listën e pagave për vitin e kaluar për të gjithë të punësuarit për të parë rrjedhen e shpenzimeve në kategorinë paga dhe mëditje. Përndryshem raporti është përgaditur mirë.

Kryetarja kërkoj nga Këshillit të dërgoj një raport shtesë për rrjedhen e shpenzimeve për paga dhe mëditje dhe të plotësohet raporti me të dhëna për planifikimin dhe krahasimi me shpenzimet në kategorinë paga dhe mëditje.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

1. I rekomandohet Kuvendit miratimin e raporti vjetor financiar të Këshillit të Pavarur për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2012.
2. Kërkohet që Këshilli, ti dërgojë komisionit informata shtesë që arsyetojnë rrjedhen e shpenzimeve në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje dhe plotësimin e raporti me të dhëna për planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve për vitin 2012.

6. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit Hetimor Parlamentar për lejimin e mjeteve buxhetore;

Kryetarja në mungesë të sekretarit apo personave përgjegjës të administratës për të dhënë sqarime për këtë pikë, propozoj që kjo pikë të shtyhet në një takim tjetër.

Sipas propozimit, Komisionit njëzëri nxorri këtë

Përfundim

Pika e 6 e rendit të ditës shtyhet për një mbledhje tjetër të komisionit, ku do ftohet Sekretarit i Kuvendit për të ofruar sqarime për këtë qështje.

Mbledhja përfundoi: 11:10.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesja e Komisionit

Safete HADERGJONAJ